

Raport nga Konferenca

Gratë Formësojnë Tranzicionin Energjetik të Kosovës

Paneli: Gratë Formësojnë Tranzicionin Energjetik të Kosovës

Pannel: Women Shaping Kosovo's Energy Transition

10:30-11:30 znj. Njomza Hoxha,

**Drejtoreshë e Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë/ Director of Kosovo
Energy Efficiency Fund**

z. Petrit Pepaj,

**Drejtor Menaxhues i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë/Managing Director of Energy
Regulatory Office**

z. Armend Ymeri,

Dekan i fakultetit të inxhnierisë së energjisë-UBT/ Dean of engineering faculty-UBT

znj. Besiana Qorraj Berisha

**Drejtoreshë e Njesisë për Implemetim të projekteve të BRE-ve, Ministria e Ekonomisë/
Director of RES Project Implementation office, Ministry of**

11:30 – 11:50 Pyetje dhe Diskutime/ Q&A

Moderator: Shend Boshnjaku

Festimi i 10 vjetëve të vizionit, ndikimit dhe lidërshipt

E/I nderuar,

Në emër të **Shoqatës së Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë (AWESK)**, kemi knaqësinë t'ju ftojme në festimin e përvjetorit që shënon një dekadë pune pioniere në sektorin e energjisë në Kosovë.

Dhjetë vjet më parë, lindi një vizion për të krijuar një platformë për përfaqësimin, fuqizimin dhe rrjetëzimin e grave në një fushë tradicionalisht të dominuar nga burrat. Sot, ndërsa Kosova përparon drejt një sistemi energjetik të qëndrueshëm, roli i grave në pozita të larta teknike dhe vendimmarrëse është më jetësor se kurrë.

Detajet e ngjarjes

- Tema: “Gratë që Formësojnë Tranzicionin Energjetik të Kosovës: Nga Vizioni në Lidërshipt dhe Transformim Sektori”
- Data: 30 Mars 2026
- Ora: 09:30 – 12:00 (pasuar me socializim dhe rrjetëzim)
- Vendi: Hoteli Swiss Diamond, Prishtinë

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj deri më **27** mars në këtë email.

Agjenda e detajuar, duke përfshirë listën e folësve dhe panelistëve është e bashkëlidhur.

Presim me padurim të festojmë këtë dekadë pune me ju,

Me të mira,

Ekipi i AWESK

Kjo ngjarje realizohet me mbështetjen e projektit "Tranzicioni i energjisë dhe zbutja e klimës në Kosovë", financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe implementuar nga Ministria e Ekonomisë dhe LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

English below

Celebrating 10 Years of Vision, Impact, and Leadership

Dear Madam/Sir,

On behalf of the **Association of Women in Energy Sector in Kosovo (AWESK)**, we are honored to invite you to anniversary celebration marking a decade of pioneering work in Kosovo's energy sector.

Ten years ago, a vision emerged to create a platform for the representation, empowerment, and networking of women in a traditionally men-dominated field. Today, as Kosova advances toward a sustainable and resilient energy system, the role of women in technical and decision-making positions is more vital than ever.

Event Details

- **Theme:** “Women Shaping Kosovo’s Energy Transition: From Vision to Leadership and Sector Transformation”
 - **Date:** March 30th, 2026
 - **Time:** 09:30 – 12:00 (followed by a Networking Reception)
 - **Location:** Swiss Diamond Hotel, Prishtina
-

Please confirm your attendance by **27 March** to this email.

The detailed agenda, including the list of speakers and panelists, is attached.

We look forward to celebrating this decade of impact with you.

Sincerely,

AWESK team

This event is carried out with the support of the “Energy transition and climate mitigation in Kosovo”, a project funded by the Grand Duchy of Luxembourg and implemented by the Ministry of Economy and LuxDev, the Luxembourg Development Cooperation Agency.

Prezentimi, Armend Ymeri

1. Cilat janë trendet aktuale në pjesëmarrjen e grave në programet e inxhinierisë së energjisë dhe a po shohim një përmirësim real apo vetëm gradual?

Përsëritet i nderuar moderator, përsëritet të nderuar përfaqësues të Institucioneve, Industrisë, Kolegë dhe pjesëmarrës.

Është nder për mua të jem pjesë e këtij paneli me një temë kaq të rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë, si: **“Roli i grave në formësimin e tranzicionit energjetik në Kosovë”**.

Kosova, siç e dimë, po kalon një fazë kritike transformimi të Sektorit të Energjisë, nga një sistem i bazuar kryesisht në Burime Konvencionale drejt një Sistemi më të Qëndrueshëm, të bazuar në Burime të Ripërtërishme (BRE), Efikasitet Energjetik dhe Digjitalizim të Rrjetit.

Tranzicion nuk është vetëm teknologjik, por është edhe social, këtu hyn roli i grave.

Nëse shohim realitetin aktual, pjesëmarrja e grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë mbetet relativisht e ulët, veçanërisht në rolet teknike dhe ato vendimmarrëse.

Në nivel global, **Gratë përbëjnë rreth 27 %** në Inxhinieri dhe Teknologji.

Pjesëmarrja e Grave në Sektorin e Energjisë **është në rritje, por mbetet strukturalisht e ulët dhe progresi është kryesisht gradual, jo transformues.**

Sa i përket studimit të vajzave në Inxhinierin të Energjisë, megjithatë, ka një sinjal pozitiv: gjithnjë e më shumë vajza po zgjedhin të studiojnë Inxhinieri të Energjisë, përfshirë edhe programet tona në Fakultetin e Inxhinierisë së Energjisë në UBT.

- Programi BsC – Inxhinieri e Energjisë
- Programi MsC – Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis

Viti akademik	Total BSc	Bachelor (F)		Total MSc	Master (F)	
2014/2015	18	4	22%	/	/	
2015/2016	32	5	16%	/	/	
2016/2017	39	2	5%	/	/	
2017/2018	48	7	15%	/	/	
2018/2019	39	2	5%	/	/	
2019/2020	109	23	21%	19	5	26%
2020/2021	46	9	20%	37	13	35%
2021/2022	/	/	/	39	14	36%
2022/2023	/	/	/	/	/	
2023/2024	/	/	/	/	/	
2024/2025	44	2	5%	/	/	
2025/2026	95	12	13%	80	28	35%

Por sfida jonë kryesore nuk është vetëm të rrisim numrin e studenteve, por edhe të krijojmë një sistem ku ato të kenë mundësi reale të zhvillohen, të qëndrojnë dhe të avancojnë në karrierë.

2. Çfarë ndryshimesh konkrete në kurrikula, metoda mësimore dhe bashkëpunim me industrinë do të ishin të nevojshme për të ndërtuar një pipeline të qëndrueshëm të grave në role teknike dhe lidershipi?

Si institucion akademik, UBT besonë se ndryshimi duhet të fillojë nga Edukimi.

Programet BSc dhe Msc Ne si UBT janë Ri-akredituar para dy viteve dhe gjate hartimit te Korikulave jemi bazuar në realitetin e ri në Sektorin Energjetik, duke integruar lëndët mesimore:

- Prodhimin e Energjisë elektrike nga BRE-të (Ere, Diell, Uje, Biomase,e tj) dhe Tranzicionin Energjetik,
- Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mjedisi.
- Digjitalizimi dhe IA, Rrjetat e Mençura, Mikrogridet, etj.

Kjo i bën studimet më gjithëpërfshirëse dhe më tërheqëse për një diversitet më të madh studentësh.

Ne Fakultetin e Inxhinierse se Energjië aplikohen Metodot mesimore Interaktive, Kalimi nga “lecture-based” në “problem-solving”, siç janë:

- **Active learning & project-based learning**, ku **vajzat (studentet)** performojnë më mirë në punë ekipore dhe projekte praktike, e që përmirësojnë cilësinë e të nxënit, por edhe rrisin besimin e vajzave në aftësitë e tyre teknike.
- **Mentorimi**, ku ne fakultetin tone ne Lendet e Praktikes çdo studente ka mentor akademik + mentor nga industria.
- Ne Fakultetin tone organizohen Konferenca vjetore IC EEE, Akademia Verore si dhe Eevente tjera, **ku permes Ligjeratave Tematike iu mundesohet grave eksperte të suksesshme në Industri, Alumnive të ligjërojnë.**
- **MoU** me Organizata te ndryshme nga Industria,e veçanerisht vlen te theksohet MoU me Shoqatat e Grave ne Sektorin e Energjisë, siç është edhe AWESK

UBT ka MoU – Mareveshje bashkëpunimi me industrinë në Kosovë (KEK, KOSTT, KEDS, ZRrE, Kompani Solare, me Ere etj), ,ku kemi **Internshipe të targetuara për student, perfshirë studentet** me programe praktike të dedikuara.


Përmes Partneritetit të fortë me Kompani Energjetike dhe Institucione, mundëshet praktikë profesionale të strukturuar mire me programe të zhvillimit të karrierës dhe mundësi konkrete për punësim për gratë në role teknike.

“Rritja e pjesëmarrjes së grave në Sektorin e Energjisë nuk është vetëm çështje barazie, por një domosdoshmëri strategjike për zhvillimin e Sektorit. Fakulteti ynë synon të ndërtojë një **pipeline** të qëndrueshëm përmes **reformës së kurrikulës, metodave inovative të mësimdhënies dhe partneriteteve të forta me industrinë**, duke krijuar kushte reale që studentet të hyjnë, të qëndrojnë dhe të avancojnë në role teknike dhe lidership.”

Në fund, dua të theksoj se: **Tranzicioni energjetik nuk mund të jetë i suksesshëm nëse nuk është gjithëpërfshirës.** Përfshirja e grave nuk është vetëm çështje e barazisë, por është çështje e **Vendimmarrjes, Inovacionit dhe Qëndrueshmërisë së Sistemit tonë Energjetik.**

Prandaj, nëse duam një Sektor Energjetik modern, të qëndrueshëm dhe konkurrues, duhet të sigurojmë që **gratë të jenë jo vetëm pjesë e këtij tranzicioni, por edhe lidere të tij.**







<https://www.facebook.com/share/p/1AS2jn1N5Y/>